



REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS.
QENDRA PER SHERBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 01 Nr. 23770
U. _____ Br. _____

Nr. i faq. 6 Data: 25/07
Gr. str. _____ Datum: 2024

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



Procesverbali i mbajtjes së dëgjimit buxhetor në fshatin Hogosht

Dëgjimi me qytetarë është organizuar nga Komisioni për organizimin e dëgjimeve buxhetore në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit dhe Kuvendin Komunal.

Njoftimet për qytetarë për organizimin dëgjimit buxhetor janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet janë bërë në Uebfaqe, në Facebook dhe në Platformën e Konsultimeve Publike.

Publikimet:

UEBFAQE:

FACEBOOK:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=885035093658824&set=pcb.884989316996735>

PLATFORMA E KONSULTIMEVE PUBLIKE:

Me **08.07.2024** dëgjimi publik është mbajtur në fshatin Hogosht duke filluar nga ora **19:30**.

Pjesëmarrës në këtë dëgjim ishin: Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Ardita Dërmaku, Drejtori i Drejtorisë për Urbanizim, Uran Berisha, Drejtori për Drejtorin e Investimeve Kapitale, Blerim Murina, zyrtarë të tjerë komunal përgjegjës për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, banor të fshatit Hogosht.

Drejtoresha Ardita Dërmaku ka hapur këtë dëgjim: Kam knaqësin të ndaj me juve detajet kryesore të buxhetit për vitin e ardhshëm, me theks të veçantë sa i përket investimeve kapitale dhe subvencioneve. Kjo është një mundësi që të merrni pjesë aktivisht në planifikimin dhe shpërndarjen e resurseve tona të ardhshme. Sygjerimet dhe komentet e juaja kanë një rëndësi shumë të madhe sepse bashkarisht më kërkesat e juaja do ta përfitojmë një draft buxhet për vitin e ardhshëm. Buxheti komunal i planifikuar për vitin 2025 do të jetë 15,282,684.00 euro ku do të ketë një rritje prej 5.10%, krahasuar me vitin 2024, ku pjesa e dedikuar për investime kapitale arrin shumën 2.6 milion, ndërsa pjesa për subvencione arrin shumën 885,000.00 euro. Nga ju pres një kontribut të madhë ku gjatë këtij takimi pres që përmes prioriteteve të juaja ti paraqitni në ato kërkesa që ju i konsideroni më të rëndësishme në fshatin Hogosht.

Më pasë Zëdhënsja e Komunës, Lidiona Marovca, ka prezantuar punët që janë bërë vitin e kaluar dhe që janë në proces: zgjerimi I rrjetit të ndriqimit publik, rr."Brigada 172 UÇK", investimi dhe ndërtimi I kolektorit të ujrave të zeza në Hogosht, rregullimi i shtratit të lumit, ndërtimi i stadiumit, investimet ne arsim renovimi i shkollës "Skënderbeu", rregullimi i hapsirës së mbrendshme, rregullimi i sistemit të ngrohjes, rregullimi I nyjevë sanitare, rregullimi i ndriqimit, rregullimi i dyerve dhe dritareve, instalimi i kamerave në shkollë, rekuzita sportive për shkollën, instalimin i sitemit të internetit, furnizimi i shkollës më llaprop dhe smart TV, 12 banor studenta kanë përfituar bursë studentore. Rrugët të cilat janë në proces të tenderimit për tu asfaltuar janë, rruga "Avdi Xhaqku", rruga "Nexhmedin Ahmeti", rruga "Martirët e Hogoshtit", rruga "Taip Sermaxhaj", rruga "Rexhep Malaj", rruga "Isa Kastrati", rruga "Shefki Latifi" dhe rruga "Lagjja e Batallve", këto janë rrugët të cilat kanë hyrë në listen e rrugëve që do të shtrohen në fshatin Hogosht.

Kërkesat e banorëve ishin të ndryshme si:

Kryetari i Kshillit Lokal Sejdi Latifaj: Faleminderit që keni gjetë kohë me ardhë, cilat projekte kanë përfundu në Hogosht, që pastaj të dim edhe ne se qfar duhet të kërkohet dhe qfar jo? Kërkesat dhe shqetësimet e qytetarëve, janë që në matjen e rrugëve të ftohëm edhe unë sepse nuk kam qenë në dijeni për investimet që po bëhen në fshatin tonë. Kërkesat e këshillit lokal janë: rr.Ali myrtaj e cila ajo rrugë vazhdon tek shtëpit e pabanushme të romve, rr. lagjen Agaj konkretisht rruga te familja Dr. Bislim Agaj si dhe rruga te familja e Osman Agaj , rruga që të shpie te Qurreli, rr. Rexhep Mihovci, rr. Haki Efendi Sermagjaj riasfaltim. Si prioritet që e ka lokaliteti Hogosht është rruga e Arave, zgjerim i rrugës, për mundësin e qasjes së bujqëve. Rruga në Dazhnic, riasfaltim 200m, rr. në Marovc, rruga e Kikës është pa asfaltuar dhe e di që ka problem me shpronsim, Shtëpia e Kulturës në Hogosht nëse mundemi me fut në renovim. Shtrimi i ndriqimit publik degëzim i rr. Avdi Xhaqku, për te Varresat, te Qurrelli, qështja e Kullës muze e Rexhep Malaj.

Drejtori i Urbanizmit Uran Berisha përgjigjet: ne jemi në procedurë të tenderimit të rrugve lokale në aferisht mbi 150 rrugë, në Hogosht janë 10 rrugë, është rruga "Avdi Xhaqku" degëzim, rruga "Nexhmedin Ahmeti" 180m, rruga "Martirët e Hogoshtit" degëzimi 1,2 dhe 3, rruga "Taip Sermaxhaj" vazhdim, rruga "Rexhep Malaj" degëzimi 1 dhe 2 , rruga "Isa Kastrati" degëzim, rruga "Shefki Latifi" dhe rruga "Lagjja e Batallve" punët e ndriqimit publik janë kërkuar, këto janë rrugët të cilat kanë hyrë në listen e rrugëve që do të shtrohen në fshatin Hogosht.

Banori Rexhep Sermagjaj: kur kemi bërë propozime në buxhetin e vitit të kaluar, a kanë hyrë ato propozimet që ne i kemi bërë, sepse propozimet që ne i kemi bërë nuk janë marë parasysh mirëpo janë marë poropozimet ad hok, ato qka ne i kemi përmend dhe propozuar kanë hy disa por jo ato qka neve na interesojnë.

Banori Xhemush Biqku: Kërkes e jemja është a ka mundësi me na vizitu me shpesh, une di qe nuk zgjidhen punet të gjitha vetëm me këtë takim, tek varrezat në fund të fshatit ka filluar një projekt dhe ka mbet e pa përfunduar, ujësjellësi ka mbet i pa përfunduar, stadioni, verrzat, ndriqimi si dhe të gjitha projekte tjera që kanë filluar dhe janë mbet të pa përfunduar.

Kryetari i Kshillit Lokal Sejdi Latifaj: për tek varrezat me 6 qershor 2023 kam bërë ankesen tek drejtorja e shërbimeve publike, kërkesa rregullimi i ujrave të zeza të demtuar nga kompania Arena, ja kam dërgu edhe fotot nga vendi i ngjarjes, përseri kam bërë ankesë për të njejtin problem.

Drejtori Uran Berisha: tek varrezat që e përmendet, ka qenë projekt i qeverisjes së kalur, mirëpo me pandim covid i krijoj disa probleme- infalacion, kanë dështu edhe disa projekte tjera dhe janë shkëput kontratat, dhe punët janë mbet aty ku janë tashmë. Kemi një kompani që e kemi kontraktuar për riparim të infrastrukturës, me kërkesën e juaj duhet të i adresohet menaxherit të kontratës, për rregullimin e gypit.

Banori Naim Agaj: unë nuk po e shoh të arsyeshme që rrugët që nuk janë të banuara nuk ka njerëz të lyp përparsi para rrugëve që janë të banuara, janë tri rrugë të tjera që janë të banueshme duke filluar nga lagjja rr. Osmon Agaj degëzim, rr. Ibrahim Agaj, 12 shpi, rr. Rrustem Latifaj, 5 shtëpi gjithësej 65-70m.

Banori Selim Jerliu: në fshatin Dazhnicë, unë e kam një fermë të lopve mirëpo jamë i bllokuar rruga nuk është e kalueshme, asfaltim i rrugës për atë vendë 180-200 metra gjatësi, që ka mundësi të rregullohet ose duhet me e shu fermën.

Kryetari i Këshillit : Lokalitetin në Poliçkë kanë kërkuar shtritjen e ndriqimit publik në fshat. Asfaltimi i rrugës në oborrin e shkollës.

Banori Vebi Kastrati: unë jamë i shqetësuar me projektet që janë të hapura, të filluara, të pa përfunduar dhe të mbetura në gjysmë, për mu shqetësim kryesor është projekti i Kullës së Rexhep Malës që nuk është duke u punuar, nuk bllokohen projektet e nisura e me nis projekte të reja, a figuron ky projekt në komunë a po jo? Riasfaltimi i rrugëve që i ka hapë firma teuta mirëpo gjysma janë të pa asfaltuara, si mahalla e epërme, mahalla e poshtme nuk është përfshi, tek sermagjt nuk është përfshi, kanë bërë punët në gjysmë. Stadioni i vjetër nuk ka filluar fare. Si dhe kanalizimi vetëm ka filluar dhe na ka mbajtur peng? Projekte të reja, pastrami i rrënojave të shtëpive të romëve, qysh mundet me u bë një zgjidhje sepse shtëpit janë të shembura dhe është shumë e rrezikshme për banorët, ky problem duhet të zgjidhet, rregullimi i ndriqimit publik nga fshati për tek qurreli, tek Kalaja, mbjellja e drunjëve dekorativ, rregullimi i trotuareve tek ura kryesore e fshatit 30 metra gjatësi, përfundimi për asfaltimi i rrugës për te arat, pastrami i mbeturinave inerte rreth pyllit mbi Hogosht, këtu në fshat ka familje që qesin në rrugë jashtë oborrit të vet mbeturina inerte- material ndërtimor, parkojnë veturat në rrugë, që është një pengesë për fshatarët, sepse rruga mbetet e pa kalueshme. Në mes stadionit sintetik dhe qurrelave, e kemi një pjesë të mirë të territorit për një park të gjelbërt, me drunjë dekorativ etj.

Drejtori Uran pergjigjet: për Kullën e Rexhep Malës nuk është kompetencë e komunës për rregullim të monumenteve, këto janë kompetencë e Ministrisë së Kulturës, Departamenti i Mbrojtjes së Monumenteve dhe Qendrës Rajonale të Gjilanit. Për stadionin e vjetër sot na kanë dërguar zotimin për fillimin e procedurave tenderuese, për rregullimin e stadionit të vjetër,

Kryetari i kshillit lokal pergjigjet: që i kanë mbyll këto pjesë të rrugëve ka qenë presion i jonë kshillit lokal që të mbyllën gropat. Na kemi bërë mundësinë që të bëhet riasfaltimi i rrugës nga shitorja e Fatonit e poshtë.

Bleranti menaxher i kontratës: kanalizimi ka filluar punën, dhe po punojnë mirë dhe e kanë kryer 600 metra, duke u bazuar në ato që i kanë pru kapacitet e kompanis dhe kanë punuar shpejt, ne i kemi pritë deri më tani, i ka kërkuar njetet financiare për të siguruar puna, në javen e ardhshme ka me fillu me pjesen tjeter e kontratëz, si dhe muri mbrojtës nga Haki Latifaj deri tek brana.

Banori Regjep Sermaghaj: Ne kemi shumë nevoj për një park, e kemi infrastrukturën afër lumit të fshatit nga rruga Haki Efendi Sermaghaj, përball shtëpis së Ilir Kastrati, projekti është i gatshëm është vendi shumë ideal për ndërtimin e një parku të gjelbërt.

Banori Rexhep Musliu: unë e kamë një shtallë, kamë bërë ankesë disa herë, më pas mundësi me zgjërë rrugën për tek arat.

Banori Naim Agaj: Unë kam kërkes për rregullimin e stacionit të policis që është urgjente.

	Propozuesi	Propozimi	Formë e Kontaktit
1.	Sejdi Latifaj	Asfaltimi i rr."Ali Myrtaj, Asfaltimi i rr. "Lagjja Agaj" Degëzim, Rregullimi i rrugës që të shpie të "Qurreli", Asfaltimi i rr. "Rexhep Mihovci", Riasfaltim i rr. "Haki Efendi Sermaghaj", Zgjërim i rr. "Te Arat", Riasfaltimi i rr. në fshatin Dazhnic, 200m, ASfaltimin e rr. në fshatrat në Marovcë dhe Kikë, Renovimi i shtëpis së kulturës, Shtrimi i ndriqimit publik degëzim i rr. Avdi Xhaqku, te Varrezat dhe te Qurreli, Përfundimi i Kullës Muze të Rexhep Malaj, Shtrirja e rrejtit të ndriqimit ublic në fshatin Poliçkë, Asfaltimi i rr. në oborrin e shkollës.	Me telefon
2.	Regjep Sermaghaj	Nërtimi i një parku të gjelbërt në rr. "Haki Efendi Sermaghaj" afër lumit.	Me telefon
3.	Xhemush Biçku	Përfundimi i projekteve,	Me telefon
4.	Naim Agaj	Asfaltimi i rr. "Osmon Agaj", degëzim, Asfaltimi i rr. "Ibrahim Agaj",	Me telefon


		Asfaltim i rr. "Rrgustem Latifaj". Gjithësej 65-70m gjatësi. Rregullimin e stacionit të policisë.	
5.	Selim Jerliu	Asfaltim i rr. në fshatin Dazhnicë, 180-200m.	Me telefon
6.	Vebi Kastrati	Pastrimi i rrënojave të shtëpive të romve, Shtrirja e rrejetit të ndriqimit public nga fshati deri tek Qurreli dhe tek Kalaja, Mbjellja e drunjëve dekorativ, Rregullimi i trotuarit tek Ura e fshatit , 30m, Asfaltimi i rrugës për tek Arat, Pastrimi dhe heqja e mbeturinave inerte, Ndërtimi i një parku të gjelbërt në mes Stadionit sintetik dhe Qurrelit,	Me telefon
7.	Regjep Musliu	Zgjërimi i rr. tek "Arat"	Me telefon

Të gjitha këto kërkesa të banorëve janë evidentuar nga anëtarët e komisionit për organizimin e dëgjimeve buxhetore, dhe ato që kanë prioritet më shumë do të inkorporohen në projekt buxhet.

Pasi që nuk kishte më kërkesa nga banorët, takimi ka mbaruar në orën 20:52 .

Procesmbajtëse:

Samire Krasniqi





Lista e pjesëmarrjes së qytetarëve për dëgjimin buxhetor në fshatin Hogosht

Data: 08.07.2024

Ora: 19:30

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri i telefonit	Email adresa	Gjinia	Përkatësia etnike	Nënshkrimi ¹²
1.	Lejohi Latifaj			M	SHQIPTAR	
2.	Rezaheq Lymashaj			M	SHQIPTAR	
3.	Naim Agazi			M	SHQIPTAR	
4.	VEBI Kastrati			M	SHQIPTAR	
5.	Deqaj					
6.	SELIM			184 M	SHQIPTAR	
7.	Rezaheq Arifi			M	Sh.	
8.	Blerant Mujaj			M	Sh.	
9.	Vokshaj			M	Sh.	
10.	Fatmir Agaj			M		
11.	Hamush Bekaj			M	Sh.	
12.						
13.						
14.						
15.						
16.						

¹ SHQ: Me këtë nënshkrim, i jap leje të plotë Komunës për të më fotografuar, dhe për të bërë xhirime të imazhit dhe zërit tim me qëllim të krijimit të përmbajtjes për komunikim, si dhe ta përdorë këtë për çdo media, qoftë elektronike apo të shtypur. SRB: Ovim potpisom dajem punu dozvolu Opština da me fotografiše i snima mene i moj glas u svrhu kreiranja komunikacionog sadržaja, kao i da isto koristi za bilo koji medij, bilo da je elektronski ili štampan.

² SHQ: Me këtë nënshkrim, unë jap pëlqimin tim që Komuna të përpunojë të dhënat e mia personale për qëllime të ligjshme, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Kosovë. SRB: Ovim potpisom dajem svoju saglasnost da Opština obrađuje moje lične podatke u zakonske svrhe, u skladu sa Zakonom o zaštiti podataka o ličnosti na Kosovu.